

|                 |       |        |
|-----------------|-------|--------|
| Pranuar më:     | 10.12 | 2024   |
| Primitje:       |       |        |
| Njësia:         |       | 515,44 |
| Jednica:        |       | 0,00   |
| 15-060/01-60803 |       |        |



**Për: Z. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit**

**Nga: Grupi i Asambleistëve të LDK-së në Lipjan**

**Lënda: Kërkesë për Takim të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Komunës**

### **I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës**

Ne asambleistët e më poshtë shënuar të Kuvendit të Komunës së Lipjanit nga grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke u bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 28.5 të Statutit të Komunës, kërkojmë që brenda afatit ligjor pas parashtrimit të kësaj “Kërkesë” të mbahet takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës, me këtë rend të ditës:

#### **1. Propozim Vendim për kundërshtimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 13 dhjetor 2023 ka marr Vendimin Përfundimtar Nr. 33/178 për shpronësimin e pronave të paluajtshme në Zonat Kadastrale Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë në sipërfaqe të përgjithshme prej 45 hektar, 90 ari e 43 m2 apo 459043 m2 me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së Re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

Lidhur me ndërtimin e kësaj deponie, disa nga ne asambleistët kemi pranuar shqetësime dhe reagime të shumta të qytetarëve të fshtarave Ribar i Madh, Poturovc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan.

Qytetarët të cilët kanë reaguar, por edhe ne asambleistët e asaj zone, vlerësojmë se hapësira e caktuar për këtë deponi është tejet e pa përshtatshme, me ndikim në ndotjen e hapësirës dhe të rrezikimit të shëndetit të banorëve të së paku të këtyre fshatrave të përmendura.


Lidhur me kushtet ligjore të përcaktimit të kësaj hapësire për Deponi sanitare, jemi konsultuar edhe me Drejtoratin për Urbanizëm, ku jemi njoftuar se sipas rregullatives në fuqi nuk janë plotësuar një mori e kriterëve për përcaktimin e kësaj hapësire.

Duke pasur parasysh këto rrethana, i propozojmë Kuvendit të Komunës të marr Vendim për kundërshtimin e ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” në zonat e caktuara kadastrale dhe të kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të shfuqizoj pjesën e caktuar të Vendimit Nr.33/178 të datës 13.12.2023 lidhur me ndërtimin e “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

Andaj kërkojmë nga të gjithë Asambleistët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit që të reagojmë përmes këtij vendimi për kundërshtim të ndërtimit të kësaj deponie.

Në emër të Grupit të Asambleistëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkesen e parashtron:

Armend Grajqevci



Lipjan, më 10 dhjetor 2024

Shtojcë:

- Lista e asambleistëve të nënshkruar, të cilët parashtrojnë kërkesë për takim të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Komunës.
- Propozim Vendimi

**LISTA E ASAMBLEISTËVE TË NËNSHKRUAR,  
TË CILËT PARASHTROJNË KËRKESË PËR TAKIM TË JASHTËZAKONSHËM TË  
KUVENDIT TË KOMUNËS**

| Nr. | Asambleisti/ja     | Nënshkrimi                |
|-----|--------------------|---------------------------|
| 1.  | Albiona Tasholli   | <i>Albiona Tasholli</i>   |
| 2.  | Armend Grajqevci   | <i>Armend Grajqevci</i>   |
| 3.  | Fadil Sopu         | <i>Fadil Sopu</i>         |
| 4.  | Fitim Shala        | <i>Fitim Shala</i>        |
| 5.  | Gazmend Qerkini    | <i>Gazmend Qerkini</i>    |
| 6.  | Gentiana Hoxhaj    | <i>Gentiana Hoxhaj</i>    |
| 7.  | Majlinda Sylejmani | <i>Majlinda Sylejmani</i> |
| 8.  | Nexhmi Lekiqi      | <i>Nexhmi Lekiqi</i>      |
| 9.  | Rinor Murati       | <i>Rinor Murati</i>       |
| 10. | Sami Bytyqi        | <i>Sami Bytyqi</i>        |
| 11. | Shefki Bytyqi      | <i>Shefki Bytyqi</i>      |
| 12. | Shkelzim Olluri    | <i>Shkelzim Olluri</i>    |
| 13. | Venhar Agushi      | <i>Venhar Agushi</i>      |
| 14. | Xhyla Dedushaj     | <i>Xhyla Dedushaj</i>     |
| 15. | Xhyzide Rustemi    | <i>Xhyzide Rustemi</i>    |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
MUNICIPALITY OF LIPJAN  
SKUPŠTINA LIPLJAN

Në bazë të nenit 44 dhe 48 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 28 dhe 29 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën \_\_\_\_\_ 2024, miraton këtë:

PROPOZIM:

## **V E N D I M** **PËR KUNDËRSHTIMIN E NDËRTIMIT TË DEPONISË SANITARE**

I. Me këtë Vendim, kundërshtohet ndërtimi i “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës në zonat kadastrale: Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë.

II. Kërkohet të bëhet shfuqizimi i pikës tre (3) të paragrafit 1 të Vendimit Nr.33/178 të datës 13.12.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

## **A r s y e t i m**

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën \_\_\_\_\_ 2024 kanë diskutuar lidhur me Vendimin Nr.33/178 të datës 13.12.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësimin e pronave të paluajtshme në ZK Poturoc, Ribar i Madh dhe Qylagë, me qëllim të ndërtimit të “Deponisë së re Sanitare” për regjionin e Prishtinës.

Ndërtimi i “Deponisë Sanitare” në zonat e caktuara kadastrale dhe në afërsi të vendbanimeve Ribar i Madh, Poturoc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan, do të ketë ndikim të theksuar mjedisor, duke përfshirë edhe ndikimin në shëndetin dhe cilësinë e jetës së banorëve.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, vlerësojnë se kjo hapësirë nuk është e përshtatshme për ndërtim të Deponisë Sanitare dhe për planifikimin e asaj zone nuk janë plotësuar një mori kriteresh sipas rregullatives në fuqi.

Komuna e Lipjanit, po ashtu ka pranuar reagime dhe shqetësime të shumta të banorëve të asaj zone, sidomos të fshatrave Ribar i Madh, Poturoc, Qylagë, Vërshec dhe Zllakuqan lidhur me ndërtimin eventual Depinisë Sanitare.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës vlerësojnë se këto shqetësime janë të bazuara, duke pasur parasysh ndikimin e Deponisë sanitare në shëndetin dhe jeten e tyre.

Duke u bazuar në rrethanat e sipërshënuara, kërkojmë nga Anëtarët e Kuvendit të aprovohet ky propozim Vendim.

Ky Vendim i dërgohet:

Qeverisë së Republikës së Kosovës;  
Kryetarit të Komunës; dhe  
Arkivit të Komunës.